



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

01Nr 06 - 877 /25

Klinë, dt: 09 - 01 /25

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e konsultimit publik për Draft-Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2025-2030, mbajtur, më 27.12.2024, me fillim nga ora 14:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyrytarja e komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, ku të pranishëm ishin drejtorë të drejtorive, zyrtarë tjerë komunalë dhe qytetarë të komunës së Klinës.

RENDI I DITËS

SHQYRTIMI I DRAFT-PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS 2025 – 2030

Marqe Tanushi -Selmanaj, nënkyrytare e Komunës: Atëherë, përshëndetje për të gjithë, të nderuar qytetarë!

Sot kam kënaqësinë të paraqes Draftin e Planit të Veprimit për Mjedisin, një dokument i hartuar me kujdes për të adresuar sfidat mjedisore dhe për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme për komunitetin tonë. Ky plan mbështetet në kuadrin ligjor të Republikës së Kosovës dhe harmonizohet me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. Ai përfshin masa konkrete për reduktimin e ndotjes, menaxhimin e mbetjeve, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.

Ky plan për veprimin e mjedisit në komunën e Klinës ka një qëllim: të promovoje një mjesi të qëndrueshëm dhe të pastër te të gjithë qytetarët. Plani do të adresojë sfidat mjedisore duke

zhvilluar një strategji që angazhon komunitetin dhe përdor burime të qëndrueshme. Në pikë të shkurtra, ky është drafti në të cilin kemi punuar disa takime ku në pjesën e takimeve që i takojnë këtij grupi kanë qenë pothuajse pjesa më e madhe, mos të them tash në numër. Kryesisht kemi qenë pothuajse të gjithë dhe i kemi gjetur ato probleme të cilat jo vetëm në komunën tonë po ka probleme edhe në gjitha komunat tjera, dhe që në të ardhmen të kemi një draft strategji se si t'i eliminojmë dhe çfarë të bëjmë për komunën e Klinës.

Pasi që nuk kemi mundësi mirënjojeje, desha ta përvendos zotëri Ragipin për punën e palodhur që e bën për qytetin tonë. Unë mendoj që qytetarët e komunës së Klinës, pjesa më e madhe e njojin dhe e dinë punën tënde dhe që ajo është mirënjoja më e mirë që ty të duhet sesa një letër dokument që ndoshta s'është asgjë, por është një pakujdesi e anës time në këtë rast dhe pjesës tjetër. Përndryshe, ti je personi më i respektuar në komunën e Klinës dhe i takon mbrojtjes dhe ruajtjes së ambientit dhe patjetër që idetë tua do ta ndihmonin këtë draft strategji dhe sigurisht që gjatë këtij debati do të dalin ide tjera, të cilat ne në të ardhmen do të mund t'i inkorporojmë dhe t'i vëmë në plan për veprim në mbrojtje të mjedisit. Faleminderit shumë. Ndoshta Xhezidja do të elaborojoë edhe më mirë në pikë të shkurtra.

Xhezide Trepça- Gashi, zyrtare për mbrojtje të mjedisit: Faleminderit, nënkyetare, përvendosje për të gjithë!

Plani Lokal për Veprimin në Mjedis është hartuar nga grupi punues i caktuar nga kryetari. Janë mbajtur disa punëtori, dhe ky plan është dokument planifikues strategjik i cili përcakton dhe adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në komunën e Klinës. Hartimi i këtij plani ka për qëllim përmirësimin e gjendjes së mjedisit në territorin e komunës.

Ky plan ka një rëndësi të veçantë për komunën, është përgjegjësi e qeverisjes lokale dhe obligim ligjor që del edhe nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit. Në Planin Lokal të Veprimit në Mjedis është vlerësuar gjendja ekzistuese e mjedisit, janë përcaktuar apo cekur problemet mjedisore, janë përcaktuar prioritetet, planet e veprimit, aktivitetet dhe projektet që do të ndërmerren për mjedisin në komunën e Klinës për një periudhë pesëvjeçare.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal dhe dokumentet strategjike të komunës. Ky plan ka qenë i publikuar në ueb-faqen e komunës dhe besoj që ndoshta e keni lexuar. Nëse keni ndonjë vërejtje ose sugjerim, i mirëpresim konkluzionet tuaja.

Marqe Tanushi-Selmanaj, nënkyetare e Komunës: Atëherë, faleminderit Xhezide! Ju ftojmë të ndani mendimet dhe sugjerimet tuaja.

Ragip Kryeziu, qytetar: A ka mundësi ndryshimi?

Marqe Tanushi-Selmanaj, nënkyetare e Komunës: Ka mundësi ndryshimi, për këtë jemi këtu.

Xhezide Trepça-Gashi, zyrtare për mbrojtje të mjedisit: Plani është hartuar dhe janë përfshirë aktivitetet. Kemi këtu listën me radhë që e kemi përfshirë pozitën gjeografike, organizimin administrativ, kushtet klimatike dhe relievin. Mandje janë llojet e tokave, gjeologjia,

infrastruktura, shëndeti publik dhe mirëqenia sociale, trashëgimia kulturore, i kemi identifikuar edhe presionet të cilat ndikojnë në mjedis. Ne e dimë të gjithë përfshirë faktorët që ndikojnë që janë popullsia dhe vendbanimet, industria, bizneset, sektori minerar, transporti, bujqësia.

Mandej e kemi përfshirë gjendjen e mjedisit, resurset ujore dhe menaxhimin e tyre, ajrin dhe zhurmën, shfrytëzimin e tokës dhe cilësinë e dheut, menaxhimin e mbeturinave, natyrën dhe biodiversitetin. Pika e fundit ka qenë pjesa kryesore, problemet kryesore mjedisore, dhe këtu i kemi përfshirë prioritetet mjedisore në periudhën 2025-2030. Në fakt, ne kemi filluar në fundvitin e 2024 në hartimin e këtij plani.

Pastaj i kemi përfshirë planin e aktiviteteve dhe veprimeve që do të realizohen në periudhën 2025-2030, planin e monitorimit, burimet dhe referencat. Ndoshta mund të hyjmë edhe në detaje.

Marqe Tanushi-Selmanaj, nënkyetare e Komunës: Vetëm diçka, nëse është draft, ka mundësi të jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja.

Xhezide Trepça- Gashi, zyrtare për mbrojtje të mjedisit: Mund ta plotësoni. Derisa është në konsultim publik, duhet të plotësohet. Nëse keni përfshirë shtuar diçka, ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe t'i shtojmë në këtë plan derisa të bëhet final dhe të dërgohet edhe në asamblenë komunale.

Ragip Kryeziu, qytetar: Kam një rekomandim: të interesohet edhe komuna përfshirë oborrin e saj, mos të ketë asgjë në rrëthanat e jetës që prek territorin këtu. Kemi disa punëtorë dhe këtu marrin rrogën, ndërsa unë jam i vetmi që punoj pa të ardhura dhe më vjen keq të vij dy-tri herë në ditë se më pengojnë mbeturinat që janë të hedhura në çdo vend.

Marqe Tanushi- Selmanaj, nënkyetare e Komunës: A ka dikush tjetër ndonjë ide? Domethënë, drafti është shkëlqyesëm i punuar. Atë që e tha Ragipi, duhet me zbatuar këtë që e kemi shkruar. Dikush tjetër nuk ka çfarë të thotë, ne i kemi zbatuar këto që kemi shkruar. Po, urdhëroni?

Adem Sejdiu, zyrtar i DUMM: Përvetësoj përfshirë! Ju përgëzoj përfshirë që keni bërë me ekipin e juaj në këtë dokument. Esenca është që ne bashkë, si institucione dhe si qytetarë, të japim kontributin tonë në eliminimin e problemeve tona që janë grumbulluar vite me radhë. Si propozim, unë e kisha parë që, sa i përket guroreve, ju e dini, d.m.th. guroret në komunën e Klinës, këto gurëthyeset po e bëjnë një ndotje goxha të madhe, sidomos në sezonin e verës. Mendoj se të gjithë së bashku duhet të koordinohemi edhe si trup, të dalim me një qëndrim, me një projekt, të bëjmë diçka konkrete në kuadër të këtij dokumenti përfshirë që eliminuar pluhurin e jashtëzakonshëm. Ka mundësi, me çfarë metode, me çfarë mënyre, unë besoj se këto pompat e ujit dhe spërkatja, sidomos në sezonin e verës, do të ishin të mirëseardhura. Po e ndotin në masë të jashtëzakonshme ambientin, është dëm i madh përfshirë komunitetin, përfshirë tokat pjellore, përfshirë agronominë e përfshirë gjë tjetër. Ky ka qenë si propozimi im. E di që është përfshirë edhe në dokumentin që sapo ju e përmendët. Faleminderit.

Marqe Tanushi-Selmanaj, nënkyetare e Komunës: Faleminderit shumë! Jo vetëm unë, por

kushdo që i bie asaj pjese të rrugës e sheh atë tmerr. Në një nga udhëtimet e fundit, ndoshta s'ka një javë, më shkoi mendja: sikur të ishte ndonjë fabrikë që së paku prodhon diçka ose kishte pasur ndonjë të punësuar në atë vend, e jo një biznes privat që përfiton një person. Nuk besoj që ka ndonjë fabrikë tjetër që është ndërtuar, edhe pse jemi kundër gjitha fabrikave. Ndërtimi, mos po ma merr fjalën Ragipi, nuk besoj që kishte me pasur ndonjë ndotje më të madhe të ajrit. Atë ditë, ka qenë mjegull në dy anët e rrugës, mezi e gjeje rrugën për të ardhur. Prandaj, plotësisht e mendoj që në këtë draft është e paraparë diçka e tillë.

Xhezide Trepça- Gashi, zyrtare për mbrojtje të mjedisit: Faleminderit shumë! E ceku kolegu dhe, edhe ajo është e përfshirë në Draft Planin Lokal të Veprimit në Mjedis. I kemi përfshirë, jam munduar t'i përfshij të gjitha, edhe për guroret, bizneset dhe çka përfshihet te ndotja e ajrit. Pastaj, menaxhimi i ujërave, e dimë edhe ndotësit e ujërave, lumenjtë, sepse Kлина zakonisht është e pasur me lumenj, por ata nuk po ruhen dhe mbrohen sa duhet. Mandjej edhe faktorët që ndikojnë në ambient dhe mjedis janë përfshirë. Të gjithë sektorët janë përfshirë: resurset ujore dhe menaxhimi i tyre, ndotja e ajrit, ndotja nga zhurma, shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut, natyra, biodiversiteti. Të gjitha janë përfshirë, edhe guroret që i ceku kolegu janë aty dhe ato janë si ndotës të ambientit.

Besoj dhe shpresoj që ky plan të merret dhe realizohet seriozisht, dhe të kemi një ambient sa më të pastër, i cili ndikon në të gjitha sferat e jetës, te natyra dhe te shëndeti i njeriut, sepse ka shumë faktorë që ndikojnë. Besoj që shumicën i kemi përfshirë, por edhe nëse ka, prapë e plotësojmë dhe e bëjmë dokument të kompletuar. Nëse doni t'i cek në detaje, te unë nuk është problem.

Ragip Kryeziu, qytetar: Ujërat e zeza që derdhen aty, a ka dikush që i kontrollon ato?

Marqe Tanushi-Selmanaj, nënkyetare e Komunës: Ragip, edhe kjo pjesë e ndotjeve të lumenjve nga kanalet e ujërave të zeza, të cilat derdhen në lumenj, të gjitha janë të përfshira: për t'i rregulluar, për t'i trajtuar, për gjetjen e një destinacioni tjetër, për të krijuar grumbullime ose impiante që janë. Gjithçka është e paraparë. Ajo fjala e parë që e ke thënë duhet të jetë e fundit edhe për ne edhe për ty. Uroj që ky draft të kalojë në plan dhe të realizohet. Nëse realizohet, do të ishte shumë mirë. Gjithçka është paraparë, veç fati i mirë është sikur të realizohet. Shumë uroj që kemi kohë katër vitet e ardhshme t'i realizojmë të gjitha me përpikëri.

Xhezide Trepça-Gashi, zyrtare për mbrojtje të mjedisit: Edhe unë ju falënderoj gjithëve për pjesëmarrjen dhe shpresoj që institucionet, së bashku me qytetarët, të angazhohen në këtë aspekt të mbrojtjes së mjedisit. Shpresoj që ky plan të realizohet për këtë periudhë, sepse ne jemi bazuar diku kur e kemi hartuar këtë plan të kornizës afatmesme buxhetore dhe të planet zhvillimore, nuk është veç në letër. Besoj se do të gjejë zbatim sepse kjo është në koordinim me të gjitha drejtoritë përkatëse dhe shpresoj që të mos jetë vetëm në letër, por të zbatohet edhe në praktikë. Faleminderit të gjithëve!

Procesmbajtësja,
Xhezide Trepça- Gashi
Marqe



KRYESUESJA,
Marqe Tanushi-Selmanaj
Marqe